



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1837/3 Prot.

Tiranë, më 09/02/2023

VENDIM

Nr. 13, datë 09/02/2023

MBI

“MIRATIMIN E RREGULLOREVE DHE KRITEREVE TË KONKURSTIT TË PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025, TË FAKULTETIT TË MUZIKËS NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Në zbatim të nenit 38 e vijim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “*Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 319, datë 13.09.2022 “Për miratimin e Statutit të UART”, shkresës nr. 80, datë 30.01.2023 të FM dhe nr. 1837/1 Prot., datë 31.01.2023 të UART, Senati Akademik i UART, pasi diskutoi mbi “Rregulloret dhe Kriteret e konkursit të pranimit për vitin akademik 2024-2025, të Fakultetit të Muzikës, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë “Bachelor” dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”/“Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, relatuar nga Dekani i FM, Prof. Dr. Isak Shehu,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Rregulloreve dhe Kriterëve të konkursit të pranimit për vitin akademik 2024-2025, të Fakultetit të Muzikës, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë “Bachelor” dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”/“Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”.
Bashkëlidhur, Rregullorja dhe kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë “Bachelor” si dhe Rregullorja dhe Kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”/“Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, të Fakultetit të Muzikës.
2. Rregulloret dhe kriteret e konkursit të dërgohen zyrtarisht në MAS, në QSHA si dhe të përditësohen në portalin U-Albania.
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të UART, së bashku me rregulloret dhe kriteret e konkurseve të pranimit të miratuara për vitin akademik 2024-2025 të Fakultetit të Muzikës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

